



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1484/6 prot

Datë 17.06.2026

V E N D I M
Nr. 818/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.06.2026, me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “CARPATHIA ALBANIA” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-83009-04-22-2026, me objekt “Blerje barna për nevoja spitalore, Spitali Rajonal Lezhe.”, me fond limit 7,166,169.79 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 05-05-2026, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
- Ankimues:** “CARPATHIA ALBANIA” SHPK me NIPT (L41629009A), me adresë: Rruga Pavaresia Ndertesa Nr. 1, Kati i Trete, Zyra 340 dhe magazine, Mezez.
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve te Perqendruara me adresë Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe

funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 23-04-2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-78358-03-05-2026, me objekt “Loti 2: Shërbim i mirëmbajtjes së ashensorëve të spitalit Rajonal Vlorë”, me fond limit 1,939,544.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 17-03-2026, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

II.2. Në datën 05-05-2026, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti

kontraktor në datën 08-05-2026, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. OE “CARPATHIA ALBANIA” SHPK me vlerë 6,980,000 lekë skualifikuar (*Operatori ekonomik s`kualifikohet për arsye se nuk plotëson kriterin 2.3.5 të Kapacitetit Teknik, të shtojcës 8 të DST-së, pasi për artikullin me nr. rendor 15 (Dantrolene Sodium 20 mg Flakon), i cili është i paautorizuar për tregtim në Republikën e Shqipërisë, OE nuk ka paraqitur asnjë dokument provues në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur, nga i cili kërkohet: a. autorizim për tregtim dhe bari të qarkullojë në njërin nga vendet e Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi, Norvegji, Islandë dhe Mbretëri e Bashkuar; /ose/ b. bari të jetë i prodhuar në vendet e Ballkanit, vetëm nëse ka marrë autorizim për tregtim dhe qarkullon në vendin e tij, /ose/ c. bari të jetë i pajisur me autorizim për tregtim nga Agjencia Evropiane e Barnave (EMA), ose Institucioni i Administrimit për Ushqimin dhe Barnat (FDA) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. d. Dhe Autorizim i lëshuar nga MAH (mbajtësi i autorizimit të tregtimit) ose prodhuesi, ose distributori i autorizuar, nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tyre në vendin tonë. Në rastin e autorizimeve të lëshuara nga distributorët e autorizuar, duhet të provohet me dokumente lidhja e tyre (distributorëve të autorizuar) me prodhuesin/MAH (mbajtësin e autorizimit të tregtimit).*

II.4. Në datën 11-05-2026, autoriteti kontraktor ka Njoftuar – anulimin e procedurës në sistemin e prokurimeve elektronike, publikuar në buletin Nr. 32 datë 18 Maj 2026 të APP-së me arsyen si më poshtë vijon:

“Arsyet e Anulimit:

në procedurat me faza nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshtatshme;

X në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme;”

II.5. Në datën 14.05.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6651 dhe me nr. nr. 1484 protokoli, datë 14.05.2026 e operatorit ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK për procedurën e prokurimit prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-83009-04-22-2026, me objekt “Blerje barna për nevoja spitalore, Spitali Rajonal Lezhe.”, me fond limit 7,166,169.79 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 05-05-2026, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 1484/1 prot., datë 14.05.2026, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Autoriteti kontraktor nëpërmjet postës, ka përcjellë shkresën nr. 1985/8/10 prot., datë 22.05.2026, protokolluar me tonën me nr.1484/3 prot., datë 25.05.2026, ku verëhet se ka dërguar vendimin e KSHA, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “CARPATHIA ALBANIA” SHPK. Referuar shkresës së sipërcituar e cila është dërguar edhe nëpërmjet postës elektronike, protokolluar me tonën me nr.1484/2 prot., datë 25.05.2026 Autoritetit kontraktor, rezulton, se ka vendosur mos pranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “CARPATHIA ALBANIA” SHPK.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton:

III.1. Lidhur ankesën e sipërcituar të OE “CARPATHIA ALBANIA” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tyre në procedurën e mësipërme të prokurimit me arsyen se: *“Operatori ekonomik s`kualifikohet për arsye se nuk plotëson kriterin 2.3.5 të Kapacitetit Teknik, të shtojcës 8 të DST-së, pasi për artikullin me nr. rendor 15 (Dantrolene Sodium 20 mg Flakon), i cili është i paautorizuar për tregtim në Republikën e Shqipërisë, OE nuk ka paraqitur asnjë dokument provues në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur, nga i cili kërkohet: a. autorizim për tregtim dhe bari të qarkullojë në njërin nga vendet e Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi, Norvegji, Islandë dhe Mbretëri e Bashkuar; /ose/ b. bari të jetë i prodhuar në vendet e Ballkanit, vetëm nëse ka marrë autorizim për tregtim dhe qarkullon në vendin e tij, /ose/ c. bari të jetë i pajisur me autorizim për tregtim nga Agjencia Evropiane e Barnave (EMA), ose Institucioni i Administrimit për Ushqimin dhe Barnat (FDA) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. d. Dhe Autorizim i lëshuar nga MAH (mbajtësi i autorizimit të tregtimit) ose prodhuesi, ose distributori i autorizuar, nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tyre në vendin tonë. Në rastin e autorizimeve të lëshuara nga distributorët e autorizuar, duhet të provohet me dokumente lidhja e tyre (distributorëve të autorizuar) me prodhuesin/MAH (mbajtësin e autorizimit të tregtimit).”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1.Në shtojcën 8 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit është kërkuar pika 2.3.5 si më poshtë vijon :

“FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

2.3.3 Për barnat (e listës së DST) të paautorizuara për tregtim në Republikën e Shqipërisë (qe nuk gjenden ne listen e barnave te regjistruar dhe nuk kanë asnjë alternativë të ngjashme, e cila ka autorizim për tregtim nga Agjencia), operatori ekonomik ofretues duhet te paraqese:

a. autorizim për tregtim dhe bari të qarkullojë në njërën nga vendet e Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi, Norvegji, Islandë dhe Mbretëri e Bashkuar;
/ose/

b. bari të jetë i prodhuar në vendet e Ballkanit, vetëm nëse ka marrë autorizim për tregtim dhe qarkullon në vendin e tij,
/ose/

c. bari të jetë i pajisur me autorizim për tregtim nga Agjencia Evropiane e Barnave (EMA), ose Institucioni i Administrimit për Ushqimin dhe Barnat (FDA) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

d. Dhe Autorizim i lëshuar nga MAH (mbajtësi i autorizimit të tregtimit) ose prodhuesi, ose distributori i autorizuar, nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tyre në vendin tonë. Në rastin e autorizimeve të lëshuara nga distributorët e autorizuar, duhet të provohet me dokumente lidhja e tyre (distributorëve të autorizuar) me prodhuesin/MAH (mbajtësin e autorizimit të tregtimit).”

III.1.2. Komisioni nga verifikimet e kryera konstaton se operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK ka dorëzuar Deklaratat me të dhënat si më poshtë për artikullin nr.15:

Nr	Emri Tregtar	Formë/Doza	Principi Aktiv	Paketimi	Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim	Prodhuesi	Origjina	Urdhri i Ministrit/Data
15	DANTRIUM	Solution for injection 20 mg	Dantrolene Sodium				Shtetet e Bashkuara te Amerikes	Autorizim i Posacem

-Gjithashtu ka deklaruar mëvetësishëm si më poshtë vijon:

Tiranë, më 05.05.2026

DEKLARATË

Unë, i nënshkruari Marsel Mali, në cilësinë e Administratorit të Operatorit Ekonomik “Carpathia Albania” sh.p.k., me NIPT L41629009A, deklaroj se medikamenti Dantrium 20 mg (Dantrolene Sodium 20 mg) është bar emergjence me përdorim të kufizuar, i përdorur për trajtimin e rasteve urgjente dhe specifike spitalore.

Deklarojmë se ky produkt nuk rezulton i regjistruar me autorizim tregtimi aktiv në regjistrin e Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM), për shkak të natyrës së tij si bar emergjence dhe përdorimit të kufizuar.

Gjithashtu deklarojmë se shoqëria “Carpathia Albania” sh.p.k. ka të drejtë të ofertojë dhe furnizojë këtë produkt pranë Autoritetit Kontraktor, në përputhje me legjislacionin në fuqi për barnat e paregjistruara, si dhe përmes procedurave dhe autorizimeve përkatëse të importit/autorizimit të posaçëm nga institucionet kompetente.

Deklarojmë se përmbushim të gjitha detyrimet ligjore dhe procedurat administrative të nevojshme për furnizimin e produktit objekt prokurimi pranë Autoritetit Kontraktor.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

III.1.4. Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.1.5. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.*

III.1.6. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar 6 kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar*

për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.7. Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 3 e VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “3.Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto

dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.1.9. Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt - shqyrtimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit, ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të plotësojnë kriterin 2.3.5. 2.3.5 Për barnat (e listës së DST) të paaautorizuara për tregtim në Republikën e Shqipërisë (që nuk gjenden në listën e barnave të regjistruar dhe nuk kanë asnjë alternativë të ngjashme, e cila ka autorizim për tregtim nga Agjencia), operatori ekonomik ofretues duhet të paraqesë: a. autorizim për tregtim dhe bari të qarkullojë në njërin nga vendet e Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi, Norvegji, Islandë dhe Mbretëri e Bashkuar; /ose/ b. bari të jetë i prodhuar në vendet e Ballkanit, vetëm nëse ka marrë autorizim për tregtim dhe qarkullon në vendin e tij, /ose/ c. bari të jetë i pajisur me autorizim për tregtim nga Agjencia Evropiane e Barnave (EMA), ose Institucioni i Administrimit për Ushqimin dhe Barnat (FDA) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Referuar kriterit të sipërpërmendur konstatohet se autoriteti kontraktor ka përcaktuar qartë se operatorët ekonomikë ofretues duhet të paraqesin autorizim të posacëm lidhur me barnat që nuk gjenden në listën e barnave të regjistruar për tregtimin e tyre sipas objektit të prokurimit. Në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur, KPP konstaton se, operatori ekonomik "CARPATHIA ALBANIA" SHPK ka dorëzuar dokumentacionin e përmendur në pikën III.1.2. të këtij vendimi. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, Komisioni konstaton se deklarat se zotëron autorizimi të posacëm për principin Dantrolene Sodium nga ky operator ekonomik nuk arrin të plotësojë kriterin 2.3.5 të dokumentave të tenderit pasi autoriteti ka kërkuar shprehimisht vetë autorizimin e posacëm dhe jo deklarin se zotën një tillë pasi nuk jep sigurin e kërkuar nga vetë autoriteti, nisur dhe nga pretendimi i vetë ankimuesit në ankesën e dorëzuar nuk ka paraqitur asnjë provë reale për zoterimin e autorizimit të posacëm sipas një prej alternativave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.5. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Sa më sipër, Komisioni gjykon se me dokumentacionin e dorëzuar operatori ekonomik ankimues nuk e plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.5 të dokumentave të tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "CARPATHIA ALBANIA" SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e OE “CARPATHIA ALBANIA” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-83009-04-22-2026, me objekt “Blerje barna për nevoja spitalore, Spitali Rajonal Lezhe.”, me fond limit 7,166,169.79 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 05-05-2026, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.
 2. Autoriteti kontraktor të vijoj me hapat e mëtejshme të procedrës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kalimin e tarifës financiare në buxhet të shtetit, të paguar nga OE “CARPATHIA ALBANIA” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

